



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 112/1 Prot.

Tiranë, më 18.01.2023

V E N D I M

Nr. 08, Datë 18.01.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 151, datë 26.09.2022, të paraqitur nga D.P kundër Departamentit të Administratës Publike¹, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Nga muaji mars 2007 e në vijim, kam qenë nëpunës i administratës publike pa ndërpreje në punë, ku kam filluar punë rishtazi pranë Komunës Lis, në Mat, në pozicionin: “Inspektor i Tatim Taksave” me kontratë pune, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe në maj të vitit 2015, jam konfirmuar si nëpunës civil pranë këtij institucioni, ku marrëdhëniet e punës në vijim janë rregulluar sipas ligjit të nëpunësit civil.

Në maj të vitit 2016, unë jam transferuar pranë Zyrës Arsimore Mat me konkurim të hapur, me lëvizje paralele, sipas procedurave të shpallura dhe të zhvilluara nga DAP, ku dhe jam emëruar nga DAP-i në pozicionin: “Specialist i Statistikës në Sektorin IT”, ndërsa në shtator të vitit 2016, unë kam konkuruar dhe jam shpallur fitues me procedurën e lëvizjes paralele brenda institucionit, për pozicionin: Specialist i Financës në Sektorin e Shërbimeve.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin DAP.

² Statusi social i ankuesit, pasi ka qenë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë (shpërdorim detyre).

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Në maj të vitit 2019, u bë riorganizimi i zyrave arsimore dhe për shkak të ristrukturimit, unë jam transferuar në Zyrën Vendore Arsimore Klos, në pozicionin: “Specialist i Financës” dhe aktualisht vazhdoj të punoj pranë këtij institucioni në të njëjtin pozicion.

Më datë 24.03.2022, unë kam aplikuar online në faqen zyrtare të DAP-it, për procedurën e lëvizjes paralele, për shpalljen : #4030 – Tiranë - Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, për të gjitha pozicionet e publikuara në këtë shpallje, si më poshtë:

- Specialist në Sektorin e të Ardhurave, në Degën e Thesarit Tiranë - kategoria: IV-b (3 vende vakante).*
- Specialist në Sektorin e Shpenzimeve Nacionale, në Degën e Thesarit Tiranë - kategoria: IV-b (4 vende vakante).*
- Specialist në Sektorin e Shpenzimeve Vendore, në Degën e Thesarit Tiranë - kategoria: IV-b (2 vende vakante).*

Pas konfirmimit të aplikimit për këto pozicione nga ana e DAP-it (email-i i datës 24.03.2022), unë kam dërguar pranë institucionit që kishte vendin vakant, kërkesën me shkrim së bashku me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme, referuar akteve ligjore dhe nënligjore për nëpunësin civil, si dhe të kriterëve të publikuara në portalin e vendeve vakante të DAP-it.

Theksoj se bashkëlidhur kërkesës, përveç dokumentave të tjera, kam dërguar edhe formularin e Vetëdeklarimit të Gjendjes Gjyqësore dhe Dëshminë e Penalitetit, ku vërtetohet gjendja ime Gjyqësore si “I Padënuar”.

Më datë 07.04.2022, kam marrë njoftim me anë të postës elektronike, nga M. Sh me detyrë “Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE)”, se nuk jam kualifikuar dhe nuk mund të vijoj më tej me procedurat, me pretendimin se unë nuk mund të aplikoj për pranim, lëvizje paralele, apo ngritje në detyrë, duke më konsideruar si të dënuar. Ky pretendim është ngritur nga ana e tyre, duke marrë si referencë Vendimit nr.70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara për këtë shpallje.

Më datë 08.04.2022, unë e kam ankimuar çështjen në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, pranë MFE-së, si dhe në DAP, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare nëpërmjet shërbimit postar, ku kam kërkuar rishqyrtimin e procedurave, pasi vendimin për të mos më lejuar mua që të vijoj me fazat e tjera të konkurimit për këtë procedurë e konsideroj si të padrejtë dhe veprim me dashje në kundërshtim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Më datë 14.04.2022, më është kthyer përgjigje nga MFE me anë të një email-i, gjithashtu po në të njëjtën datë DAP-i ka publikuar përgjigjen e ankimit në faqen zyrtare.

Pretendoj se nga DAP-i janë shkelur rregullat gjatë procedurave të rekrutimit të punonjësve, pasi DAP-i ka detyrimin që të mbikqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, referuar nenit 7, pika c, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

DAP-i nuk ka ndjekur të njëjtën praktikë, por ka punuar me dy standarte, pasi ka mbajtur qëndrime të ndryshme nga njëra procedurë në tjetrën, megjithëse kushtet kur janë zhvilluar këto procedura kanë qenë të njëjta.

Në janar të vitit 2020, unë kam aplikuar për pozicionin: “Specialist në Degën e Thesarit Mat” shpallja: #2534, procedurë kjo e shpallur, nga DAP-i dhe që është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, pranë MFE-së në bashkëpunim me DAP-in. Kriteret e pranimit për këtë procedurë dhe baza ligjore për këtë pozicion kanë qenë plotësisht të njëjta me kriteret e përcaktuara në shpalljen: #4030, për pozicionin: “Specialist në Degën e Thesarit Tiranë”. Megjithëse referenca ligjore për të dyja këto shpallje ka qenë e njëjtë, kushtet dhe kriteret e pranimit kanë qenë të njëjta, institucioni që ka publikuar dhe administruar procedurat e rekrutimit ka qenë i njëjti, gjendja ime shoqërore dhe dokumentacioni i kërkuar kanë qenë po njësoj, por çuditërisht unë jam trajtuar në forma të ndryshme nga njëra procedurë në tjetrën.

Tek procedura e parë (shpallja #2534), aplikimi im është pranuar dhe unë kam marrë pjesë në konkurim dhe jam kualifikuar në të dyja fazat: në fazën e parë, të verifikimit të kandidatëve, të cilët përmbushin kriteret e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim, si dhe në fazën e dytë, vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë, ndërsa tek procedura e dytë (shpallja: #4030), nuk më kanë lejuar që të marr pjesë në konkurim!

I vetmi institucion që nuk më ka lejuar që të marr pjesë në konkurim është DAP-i, pasi unë në të njëjtën periudhë kam aplikuar dhe kam marrë pjesë në konkurim edhe për disa pozicione vakante të publikuara dhe që janë zhvilluar nga institucione të pavarura shtetërore, që nuk janë nën varësinë dhe nën presionin e DAP-it, por mënyra e zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe baza ligjore ku ato janë mbështetur kanë qenë të njëjta.

DAP-i më ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese edhe për faktin se persona të tjerë me të cilët unë ndodhem në kushte të barabarta, janë lejuar që të punojnë si nëpunës civil, ndërsa mua s’më kanë lejuar që të marr pjesë në konkurim me procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë. Kjo pabarazi mund të provohet po me të njëjtin dokument që DAP-i e përdor për të më penalizuar mua dhe konkretisht me Vendimin nr. 70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Ky vendim është keqinterpretuar qëllimisht nga DAP-i, për të arritur qëllimet e veta diskriminuese në kundërshtim të ligjit, pasi:

Së pari, vihet re se nga gjykata, si masë dënimi përfundimtar nuk është caktuar dënim me burg, por me 240 orë punë në interes publik. Gjykata ka urdhëruar që unë të mbaj kontakte me shërbimin e provës dhe nuk ka dalë asnjë urdhër arresti ndaj meje, pra unë s’kam bërë kurrë

burg. DAP-i e anashkalon faktin se unë e kam kryer punën me interes publik para vitit 2020, dhe sipas nenit 63 të Kodit Penal dënimi alternativ quhet “I paqenë”.

Së dyti, DAP-i nuk më lejon mua që të marr pjesë në konkurim, duke marrë si referencë vetëm Vendimin nr. 70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, por nuk e ka marrë aspak në konsideratë faktin se pjesë e këtij vendimi është edhe A. S, i cili ka kryer të njëjtën masë dënimi dhe rezulton të jetë i punësuar si nëpunës civil pranë Bashkisë Mat, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave”. Unë jam i bindur se Vendimi nr. 70, datë 27.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat nuk përbën asnjë pengesë për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për këtë A.S është në të drejtën e tij, sikurse janë qindra të tjerë, të cilët kanë kryer dënime të ngjashme dhe vashdojnë të jenë pjesë e shërbimit civil, por trajtimi i pabarabartë i dy personave me të njëjtat kushte, që kanë kryer të njëjtën masë dënimi, të vendosur nga e njëjta gjykatë, me të njëjtin vendim, në të njëjtën kohë, ku njëri quhet “I dënuar” dhe nuk lejohet që të marrë pjesë në konkurim, ndërsa tjetri quhet “I padënuar” dhe lejohet të punojë si nëpunës civil, tregon më së miri qëndrimin diskriminues të DAP-it ndaj meje, duke më penalizuar pa shkak, për interesa personale që s’kanë të bëjnë fare me ligjin.

DAP-i më ka përjashtuar nga procedurat e konkurimit për shkak të gjendjes sime shoqërore të mëparshme, duke patur si qëllim që unë t’a kem të pamundur që të ushtroj të drejtën për punësim, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, nëpërmjet procedurave me lëvizje paralele dhe ngritjes në detyrë dhe për të arritur këtë qëllim, dyshoj se DAP-i ka ushtruar edhe presion mbi anëtarët e komisioneve të ngritura pranë institucioneve ku unë kam aplikuar.

Unë kam qenë pjesë e administratës publike edhe gjatë periudhës që DAP-i pretendon se unë e kam të ndaluar që të ushtroj funksione publike për 20 vjet, madje unë kam bashkëpunuar me DAP, jam trajnuar dhe konfirmuar si nëpunës për pozicionin ku aktualisht punoj.

Unë kam marrë pjesë në disa procedura me lëvizje paralele/ngritje në detyrë dhe jam kualifikuar nga institucione të tjera, konkretisht nga Bashkia Tiranë, dhe mbi të gjitha nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, organi më i lartë në Shqipëri, i pavarur, që ndër të tjera auditon edhe zbatimin e dispozitave ligjore, për përcaktimin e strukturave organike, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe plotësimin e vendeve vakante (pika 14, Detyrat kryesore, Rregullorja e brendshme e funksionimit të KLSH, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.53, datë 16.04.2012”).

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, punësimin e tij pranë Degës së Thesarit Mat, për pozicionin ku është shpallur fitues dhe lejimin për të marrë pjesë në konkurim dhe për t’u punësuar në pozicione të tjera të shërbimit civil.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁴, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të

⁴ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1288/1, datë 29.09.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar DAP-in për ankesën e bërë nga D.P, si dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të plotë të korrespondencës me ankuesin për të gjitha procedurat e konkurimit dhe ankesat e bëra nga D.P, të përmendura në ankesë.
 - Informacion nëse ka nëpunës civil të tjerë (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin), që kanë aplikuar për lëvizje paralele dhe janë skualifikuar apo nuk janë pranuar për konkurim, gjatë periudhës nga data 01.01.2020 deri në datë 23.03.2022. Nëse po, kopje të procedurave.
 - Shpjegime lidhur me pretendimin e ankuesit se dhe A.S, ka kryer të njëjtën masë dënimi si ankuesi dhe rezulton se është i punësuar si nëpunës civil pranë Bashkisë Mat.

- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve dhe vendimit të gjykatës (nëse ka).

Me shkresën nr. 5590/2, datë 07.10.2022, DAP-i, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Në zbatim të VKM nr. 77, datë 20.02.2019 “Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2019, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil”, i ndryshuar, si dhe me qëllim plotësimin e vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, pjesë të shërbimit civil, DAP ka vijuar me shpalljen e vendeve të lira të sistemit të MFE-së.

Në këtë kuadër, nëpërmjet kodit nr. #2534, DAP-i ka shpallur në faqen zyrtare www.dap.gov.al, procedurën e lëvizjes paralele dhe atë të pranimit në shërbimin civil, për plotësimin e vendeve të lira të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, në rajone. Konkretisht, me shpalljen me kodin nr. 2534 janë publikuar për rekrutim vendet e mëposhtme:

1. Specialist në Degën e Thesarit Has - kategoria IV-b;
2. Specialist në Degën e Thesarit Mat - kategoria IV-b;
3. Specialist në Degën e Thesarit Mat - kategoria IV-b;
4. Specialist në Degën e Thesarit Mirditë - kategoria IV-b;
5. Specialist në Degën e Thesarit Puke - kategoria IV-b;
6. Specialist në Degën e Thesarit Kukës - kategoria IV-b.

Rezulton të jetë proceduar fillimisht me fazën e lëvizjes paralele dhe për rrjedhojë njësia e burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ka verifikuar dosjet e kandidatëve pjesëmarrës, bazuar në parashikimet e VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 7. Në përfundim të verifikimit, nga ana e organit publik kompetent është shpallur edhe lista përfundimtare e kandidatëve të cilët janë kualifikuar për në fazën e intervistës së strukturuar me gojë, midis të cilëve edhe ankuasi. Theksojmë se, D.P ka shprehur interesin si kandidat vetëm për 2 pozicionet e punës, Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b.

Në vijim, lista me emrat e secilit kandidat të kualifikuar i është njoftuar Komitetit të Brendshëm për Lëvizjen Paralele (KBLP) dhe procedura e rekrutimit ka vijuar normalisht. KBLP-ja në cilësinë e organit kompetent, ka proceduar me zhvillimin e intervistës dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve pjesëmarrës dhe në përfundim ka vlerësuar secilin prej tyre. Vlerësimet i janë përcjellë njësisë së burimeve njerëzore, e cila më pas ka njoftuar kandidatët fitues dhe ata jofitues, individualisht nëpërmjet adresës së tyre elektronike (me e-mail). Për dy pozicionet e punës Specialist në Degën e Thesarit Mat, nga KPLP-ja janë shpallur fitues me mbi 70 pikë, D.P dhe D. K.

Bazuar në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që

zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, DAP është organi përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.

Në datën 06.02.2020 D.P është paraqitur pranë DAP që të plotësojë dhe dorëzojë njëkohësisht formularin e vetëdeklarimit me qëllim nxjerrjen e aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse, në pozicionin ku është shpallur fitues nga KBLP-ja. Ky formular është regjistruar me numrin unik të identifikimit 2006 M 0251 dhe më pas DAP ka vijuar me procedurën e verifikimit të përcaktuar në Kreun V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit të ankuesit u konstatua se, në seksionin III (Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit), në përgjigje të pyetjes numër 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet shqiptar ose i huaj?”, D.P ka deklaruar se, është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Ankuesi, D.P i ka bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit dhe Vendimin nr. 70, datë 27.6.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, sipas të cilit është deklaruar fajtor për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite është dënuar me 1 (një) muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, për të pandehurin D.P, duke e konvertuar këtë dënim me 240 orë pune në interes publik. Për ekzekutimin e vendimit të mësipërm, gjykata ka vendosur detyrimin e D.P që të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Me Vendimin nr. 980, datë 15.07.2019 Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve përcolli pranë DAP, Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për subjektin vetëdeklarues të D.P ku rezulton se, në bazë të Vendimit nr. 70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të nenit 248 të Kodit Penal është dënuar me 1 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim duke e zëvendësuar me detyrimin e të pandehurit që të kryejë 240 orë pune në interes publik. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit, e cila me Vendimin nr. 980, datë 15.07.2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Me shkresën nr. 2965/1, datë 31.12.2019 të Bashkisë Mat rezulton se, shtetasi ka kryer dënimin alternativ me orë pune.

Në përfundim të hetimit administrativ DAP-i konstatoi se, për shkak të veprës penale të kryer (shpërdorimit të detyrës) dhe dënimit të marrë, ankuesi ndodhet në kushtet e ndalimit ligjor për t'u emëruar në një pozicion pune pjesë të shërbimit civil në administratën shtetërore, konkretisht ai përfshihet në sferën e ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar dhe brenda periudhës së ndalimit, të përcaktuar në nenin 4, pika 2, të këtij ligji. Për pasojë, DAP-i nuk mund të procedojë me nxjerrjen e aktit të tij të emërimit në pozicionin, Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b, ku është shpallur fitues nga ana e KBLP-së.

Në nenin 2, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, sanksionohet se: "1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiake ose të qarkut, personal të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve"; të Kodit Penal.

Në shkronjën e, në pikën 1, të nenit 3, të ligjit 138/2015, i ndryshuar parashikohet se: "Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë: e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;".

Nga dispozitat e mësipërme vërehet se, ndalohet emërimi i funksionarëve publikë në shërbimin civil, në rast se ata janë dënuar me burgim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës siç ka ndodhur në rastin e ankuesit, D.P, sipas nenit 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Ndërkohë, për sa i përket afatit të ndalimit, ligji 138/2015, i ndryshuar, në nenin 4, pika 2, të tij parashikohet se: "2. Për personat e dënuar për veprat penale që parashikohen nga shkronja "b", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë".

Referuar pikës 9, të nenit 4, të ligjit 138/2015, i ndryshuar, rezulton se: "Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedurë të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj:". Sipas këtij parashikimi, pezullimet e dënimit, amnistia, falja, e masa të tjera alternative të dënimit me burgim, nuk ndikojnë në zbatimin e ligjit

138/2015, i ndryshuar dhe për rrjedhojë edhe në rastin e ankuesit, pezullimi i zbatimit të dënimit me burgim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës nuk pengon zbatimin e këtij ligji.

Për të materializuar veprimtarinë administrative DAP-i ka nxjerrë Vendimin nr. 4, datë 17.02.2020 me të cilin ka vendosur: “1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, për D.P, procedurën administrative të lëvizjes paralele në shërbimin civil, të shpallur në faqen zyrtare të DAP-it me kodin nr. #2534, për 2 (dy) pozicionet e punës Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b, për shkak të pamundësisë së realizimit të objektit dhe qëllimit të saj. 2. Të mos nxjerrë aktin e emërimit për D.P në dy pozicionet ku ai është shpallur fitues nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b. 3. Të njoftohen D.P dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për këtë vendimmarrje të njësisë përgjegjëse DAP. 4. Ngarkohet Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Departamentin e Administratës Publike, për zbatimin e këtij vendimi. 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. 6. Ndaj këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e marrjes dijeni”.

Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen si më lart të organit publik, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë-padinë me objekt: “1. Shfuqizimi i Vendimit nr. 4, datë 17.02.2020 i Departamentit të Administratës Publike; 2. Emërimin e paditësit në dy pozicionet e punës ku ai është shpallur fitues nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b”; me palë të paditur: DAP dhe person i tretë: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega e Thesarit Mat, ku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me Vendimin nr. 1597, datë 17.07.2020 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi: “Rrëzimin e kërkesë padisë”. Ndaj këtij vendimi ankuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit.

Sjellim në vëmendje se, në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin e përpunimin e të dhënave të pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit, nga subjektet e përcaktuara në shkronjën “gj”, të pikës 4, të kreut II, të Vendimit 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, DAP në kuadër të ligjit 138/2015, i ndryshuar dhe këtij vendimi, mbart ndër të tjera detyrimet si më poshtë vijon:

- i. Publikimin dhe përditësimin në faqen zyrtare të internetit të listës së funksionarëve /nëpunësve që kanë depozituar pranë DAP formularë vetëdeklarimi;
- ii. Publikimin në faqen zyrtare të internetit të formularëve të vetëdeklarimit të depozituar pranë DAP, nga çdo punonjës/nëpunës i emëruar;
- iii. Publikimin dhe përditësimin e listës së subjekteve vetëdeklarues të cilët pas verifikimit, janë konstatuar nga DAP në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas ligjit 138/2015, i ndryshuar.

Në respektim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, në këtë listë, ndër të tjera do të gjeni të publikuar emrin e ankuesit, si dhe shtetasit, M. V, për të cilin, organi përgjegjës DAP sikurse në rastin e D.P ka vendosur deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës

administrative të pranimit në shërbimin civil, për shkak të konstatimit të tij në kushtet dhe brenda periudhës së ndalimit për t'u emëruar në një funksion publik, sipas ligjit 138/2015, i ndryshuar.

Nga të dhënat që administrojmë rezulton se, D.P ka vijuar të aplikojë në procedurat e konkurrencimit, përfshirë dhe shpalljen #4030-Tiranë-Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, të cituara nga ana e ankuesit në pretendimet e tij. Gjatë fazës së verifikimit paraprak në të cilën verifikohet plotësimi i kriterëve të përgjithshme dhe ato të posaçme të kandidatëve është konstatuar se, D.P vijon të jetë në të njëjtat kushte, për të cilat DAP ka marrë vendimin nr. 4, datë 17.02.2020, “Për deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës administrative të lëvizjes paralele, të shpallur në faqen zyrtare të DAP-it me kodin nr. #2534, për 2 (dy) pozicionet e punës Specialist në Degën e Thesarit Mat, për D.P”, e për rrjedhojë është skualifikuar. Mbi pretendimet e ngritura në ankesën e përcjellë nga ana juaj, rezulton se, D.P është sqaruar edhe me shkresën nr. 6535/1, datë 24.12.2021 të DAP.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se, shtetasi A. S, ka kryer të njëjtën masë dënimi si ankuesi dhe rezulton se është i punësuar si nëpunës civil pranë Bashkisë Mat, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave, DAP sqaron se:

Në kuptim të nenit 4, pika 1, germa “f”, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, DAP është njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore (aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit), ndërkohë që për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore është njësia e burimeve njerëzore.

Ndërkohë, bazuar në ligjin nr. 138/2015, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, DAP është organi përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Referuar pikës 1 dhe 3, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, subjektet që kandidojnë apo kërkojnë të zgjidhen/emërohen në një nga pozicionet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, në të njëjtën kohë me kërkesën për kandidim në funksionin publik, janë të detyruar që të depozitojnë edhe formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi. Kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit nuk përfshin detyrimin për depozitim të një kërkesë formale nga subjekti, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Në vijim, formularët e vetëdeklarimit, për subjektet e përcaktuara në shkronjën "gj", të pikës 4, të kreut II, të Vendimit 17/2016 të Kuvendit përcillen pranë DAP, si organi përgjegjës për administrimin dhe përpunimin e tyre”.

Në përgjigje të shkresës së DAP-it, subjekti ankues me shkresën e protokolluar me tonën nr. 1288/3, datë 26.10.2022 ka kundërshtuar përgjigjet e dhëna nga DAP, dhe ndër të tjera ka informuar se: *“DAP ka hartuar shkresën me nr. 5590/2, datë 07.10.2022, ku me anë të saj është shprehur se pretendimet e mia janë të pabazuara në prova dhe ligj. Në lidhje me këtë nga ana e DAP, jo vetëm që nuk është paraqitur asnjë argument dhe provë që të hedhë poshtë pretendimet e mia, por madje DAP disa nga çështjet që unë kam parashtruar, i ka anashkaluar duke mos dhënë asnjë sqarim dhe për çështje të tjera ka dhënë informacion të paplotë dhe të pasaktë. Unë pretendoj se nga DAP-i janë shkelur rregullat gjatë procedurave të rekrutimit të punonjësve dhe përgjegjësi kryesor për moszbatimin e këtyre rregullave, është DAP. Në fakt unë kam shprehur interes dhe kam aplikuar për të marrë pjesë në konkurim për shumë procedura me lëvizje paralele, apo ngritje në detyrë dhe që jam trajtuar padrejtësisht nga DAP-i.*

Për sa është shprehur DAP, se nuk ka asnjë përgjegjësi dhe dijeni për A. S nëse është i punësuar pranë Bashkisë Mat, duke i kërkuar informacion Bashkisë me shkresën nr. 5590/1, datë 04.10.2022, dua të them se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi referuar nenit 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, pika 2 (ë), “DAP ka si detyrë administrimin e Regjistrimit Qëndror të Personelit”; pika 3 (a), “DAP ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësisve të tij”; pika 4, “Çdo institucion, që punëson nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik dhe nëpunës civil, që kanë kompetenca menaxheriale vendimmarrëse ose që kanë informacione në këtë fushë, janë të detyruar të bashkëpunojnë me DAP-in”.

Nuk është me rëndësi sot, fakti nëse punon apo jo A. S pranë Bashkisë Mat, e rëndësishme është se ai ka punuar gjatë periudhës së cilës mua më është mohuar kjo e drejtë dhe ndaj tij nuk është marrë asnjë masë për t'a penguar. Është e provueshme se DAP-i ka pas dijeni, për persona të tjerë me të cilët unë ndodhem në kushte të njëjta, dhe janë lejuar që të punojnë si nëpunës civil, siç është rasti i A.S, i cili është pjesë e të njëjtit vendim gjykate me të njëjtën masë dënimi. Unë shpeshherë kam kërkuar informacion në lidhje me këtë, por pa dhënë emra konkret, pasi emrin e A. S, DAP e kishte mbi tavolinë dhe mund t'a verifikonte fare lehtë në sistem (Regjistrin Qëndror të Personelit), por kjo nuk ka ndodhur dhe kurrë unë nuk kam marrë përgjigje për këtë. DAP duhet të mbajë përgjegjësi se pse nuk ka vepruar dhe nuk ka kërkuar më parë informacion për A. S, nëse ka punuar pranë Bashkisë Mat.

- Me shkresën nr. 1288/4, datë 31.10.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga DAP, kopje të shkresës dërguar Bashkisë Mat, lidhur me punësimin e shtetasit A. S dhe përgjigjes së dhënë nga Bashkia.

Me shkresën nr. 5590/7, datë 08.11.2022, DAP-i, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me shkresën nr. 4201/3, datë 20.10.2022 Bashkia Mat ka informuar se, A. S është i punësuar në Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkiake, pranë Bashkisë Mat, në pozicionin: Punonjës i Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe Dekorit, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pozicion ky i cili nuk është shërbim civil. Për sa më sipër, konstatohet se A. S, në pozicionin e*

sipërcituar, nuk përfshihet në detyrimin e përcaktuar në shkronjën "gj", të pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pas verifikimit të kryer në Sistemin Informatik të Regjistrimit Qendror të Personelit (RQP) rezulton se, për A. S, nuk është pasqyruar asnjë e dhënë. Gjithashtu, lidhur me pretendimin e ankuesit se dënimi i dhënë ndaj tij konsiderohet i paqenë në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, të ndryshuar, duke u konsideruar i padënuar/i rehabilituar, DAP sqaron se, instituti i rehabilitimit penal, parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal, të ndryshuar, njihet për efekt të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, vetëm nëse jemi përpara rastit kur subjekti vetëdeklarues ka kryer një krim me dashje për të cilën është dhënë masa e dënimit jo më pak se gjashtë muaj. Konkretisht, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, ky afat për ankuesin zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe ndaj tij nuk aplikohet instituti i rehabilitimit, i parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal, i ndryshuar.

Referuar pretendimeve të ankuesit mbi shpalljen #3692 sqarojmë se, në zbatim të pikës 7, të Kreut VII, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, është njësia e burimeve njerëzore, që në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim.

Nga të dhënat që administrojmë rezulton se, njësia e burimeve njerëzore pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me datë 13.09.2021, ka njoftuar D.P mbi arsyet e moskualifikimit të tij për fazën e dytë të procedurës së konkurimit, atë të intervistës së strukturuar me gojë.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i disponuar pranë DAP-it, evidentohet se ankuesi nuk mund të merrte pjesë në procedurat e rekrutimit, të shpallura nga DAP, për shkak të pengesës ligjore të parashikuar nga ligji 138/2015, i ndryshuar, ku për rrjedhojë është njoftuar dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit".

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: "‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësoje me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/b, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen shoqërore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Mbështetur në nenin 22, të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, punësimi në institucionet e administratës shtetërore, i cili është pjesë e shërbimit civil, kryhet nëpërmjet procedurës së rekrutimit, procedurë e cila zhvillohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) si njësi përgjegjëse.

Bazuar në sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur nëpërmjet kodit nr. #2534, procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin: Specialist në Degën e Thesarit Mat-kategoria IV-b.

Referuar nenit 26, pika 3, gërmat a) dhe b), të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për procedurën *“Lëvizje paralele”* kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, ndërkohë që për procedurën *“Ngritje në detyrë”* kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në nenin 22, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, parashikohet:

- *Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur.*
- *Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
- *Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: - verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit; - vlerësimi i kandidatëve.*
- *Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimi, i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
- *Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimi, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm.....”.*

Në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme që një kandidat duhet të plotësojë për t’u pranuar në shërbimin civil. Konkretisht, konkurenti në mes të tjerash duhet: “d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje”.

Bazuar në thirrjen e mësipërme, ka konkuruar ankuesi për pozicionin e specialistit në Degën e Thesarit Mat, i cili është shpallur fitues së bashku me një konkurrence tjetër.

Në nenin 1 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji”.

Në Vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, Kreu II. Rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, pika 4/gj, përcaktohet se: “Formulari i vetëdeklarimit dorëzohet dhe administrohet nga: gj) Departamenti i Administratës Publike, për nëpunës në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil”, ndërsa në Kreun V. Procedura e realizimit të verifikimit, pika 1, përcaktohet se: “Përpara fillimit të detyrës, emërimit apo zgjedhjes për një nga funksionet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit 138/2015, organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit është i detyruar të verifikojë të dhënat e deklaruara nga personi”.

Në vijim, ankuesi është paraqitur pranë DAP që të plotësojë dhe dorëzojë formularin e vetëdeklarimit me qëllim nxjerrjen e aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse, në pozicionin ku është shpallur fitues nga Komiteti i Brendshëm për Lëvizjet Paralele.

Referuar Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore datë 17.02.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për D.P rezulton se: *“Në bazë të Vendimit nr. 70, datë 27.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të nenit 248 të Kodit Penal e dënnon me 1 (një) muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke e zëvendësuar me detyrimin e të pandehurit që të kryejë 240 orë pune në interes publik. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit, e cila me Vendimin nr. 980, datë 15.07.2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Me shkresën nr. 2965/1, datë 31.12.2019 të Bashkisë Mat rezulton se, shtetasi ka kryer dënimin alternativ me orë pune. Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal quhet i padënuar”*.

Në nenin 2, pika 1, germa “b”, të ligjit 138/2015, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiake ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuara në Kreun X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”; të Kodit Penal”*.

Në nenin 3, pika 1/e, të ligjit 138/2015, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalimi për t’u emëruar në një funksion publik. 1. Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë: e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;”, ndërsa në nenin 4, pika 2, përcaktohet se: *“Periudha e ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar. 2. Për personat që parashikohen nga shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë”.**

Departamenti i Administratës Publike me Vendimin nr. 04, datë 17.02.2020 *“Për deklarimin të përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës administrative të lëvizjes paralele, të shpallur në faqen zyrtare të DAP-it me kodin nr. #2534, për dy pozicionet e punës specialist në Degën e Thesarit Mat, për D.P”*, vendosi të mos nxjerrë aktin e emërimit për D.P në dy pozicionet ku është shpallur fitues, pasi rezultoi i dënuar me veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 të Kodit Penal, i ndryshuar) dhe për këtë veprë penale ligji nr. 138/2015, i ndryshuar, neni 2, pika 1, shkronja “b”, neni 3 dhe 4, parashikon ndalimin e ushtrimit të funksionit publik në shërbimin civil, për një periudhë prej 20 vitesh.

Ankuesi duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e DAP-it në datë 06.03.2020, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë-padinë me objekt: *“1. Shfuqizimi i Vendimit nr. 4, datë 17.02.2020 të DAP; 2. Emërimin e paditësit (D.P) në dy pozicionet e punës ku ai është shpallur fitues nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, Specialist në Degën e Thesarit Mat, kategoria e pagës IV-b”*.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr. 1595 (1597), datë 17.07.2020 vendosi: *“Rrëzimin e kërkesë padisë”* të ankuesit.

D.P me ankimin datë 12.08.2020 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilin ka kundërshtuar Vendimin nr. 1595 (1597), datë 17.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Çështja është në proces dhe Komisioneri nuk do shprehet për këtë çështje, pasi po shqyrtohet nga Gjykata.

Lidhur me aplikimet e bëra më pas nga ankuesi me nr. #3692 dhe #4030, rezulton se nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë që të shprehet mbi pengesat ligjore që ka ankuesi, si dhe gjendja gjyqësore e tij nuk ka ndryshuar. Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike ka skualifikuar ankuesin nga aplikimet e mëpasshme për pozicionet ku ka konkuruar.

Në këto kushte, Komisioneri do shqyrtojë ankesën lidhur me trajtimin e pabarabartë të ankuesit nga ana e DAP-it krahasuar me subjekte të tjerë vetëdeklarues.

Për të vlerësuar në lidhje me pretendimet e ankuesit, Komisioneri kërkoi nga DAP, informacion nëse ka nëpunës civil të tjerë (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin), që kanë aplikuar për lëvizje paralele dhe janë skualifikuar apo nuk janë pranuar për konkurim. Lidhur me këtë, DAP dërgoi kopje të Vendimit nr. 02, datë 03.02.2021 për shtetasin, M. V, për të cilin, DAP sikurse në rastin e D.P ka vendosur deklarinimin e përfundimit pa një vendim përfundimtar të procedurës administrative të pranimit në shërbimin civil, për shkak të konstatimit të tij në kushtet dhe brenda periudhës së ndalimit për t'u emëruar në një funksion publik, sipas ligjit 138/2015, të ndryshuar.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se:

Departamenti i Administratës Publike me Vendimin nr. 02, datë 03.02.2021 *“Për deklarinimin të përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës administrative të pranimit në shërbimin civil, të shpallur në faqen zyrtare të DAP-it me kodin nr. #3102, për pozicionet e punës specialist në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër, për M. V”*, ka vendosur të mos nxjerrë aktin e emërimit për M. V në pozicionin ku ai ka përzgjedhur, Specialist në Sektorin e Ekstensionit Bujqësor Lezhë, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër apo pozicionet e tjera të shpallura për rekrutim me kodin nr. #3102.

Në arsyetimin e vendimit, DAP në mes të tjerash ka konstatuar se: *“Bazuar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore nr. 11, datë 14.01.2021, të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*

me shkresën nr. 309/1, datë 15.01.2021, rezulton se me vendimin nr. 138, datë 16.09.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor, për veprat penale “Shpërdorim detyre”, e në bazë të nenit 248 të Kodit Penal dënohet me 12 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe vihet në provë për 2 vite..... DAP-i vëren se në rastin konkret M.V është dënuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 të Kodit Penal, i ndryshuar) dhe për këtë vepër penale ligji nr. 138/2015, i ndryshuar, neni 2, pika 1, shkronja “b”, neni 3 dhe 4, parashikon ndalimin e ushtrimit të funksionit publik në shërbimin civil, për një periudhë prej 20 vitesh. Si rrjedhojë, për shkak të veprës penale të kryer, M. V ndodhet në kushtet e ndalimit ligjor për t’u emëruar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil në administratën shtetërore dhe DAP-i nuk mund të procedojë me nxjerrjen e aktit të tij të emërimit”.

Gjithashtu, referuar listës⁵ së subjekteve vetëdeklarues të cilët pas verifikimit, janë konstatuar nga DAP në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas ligjit 138/2015, i ndryshuar, rezulton se në këtë listë janë 149 persona të cilët janë konstatuar nga DAP në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik dhe emri i ankuesit rezulton te jetë në këtë listë në numrin rendor 40 dhe M. V në numrin rendor 102.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se, shtetasi A. S, ka kryer të njëjtën masë dënimi si ankuesi dhe rezulton se është i punësuar si nëpunës civil pranë Bashkisë Mat.

Referuar shkresës nr. 4201/3, datë 20.10.2022 të Bashkisë Mat, rezulton se A. S është i punësuar në Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkiake, pranë Bashkisë Mat, në pozicionin: Punonjës i Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe Dekorit, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Rezulton se pozicioni i punës i A.S si punonjës i Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe Dekorit ashtu si dhe pozicioni i punës i ankuesit si specialist i financës në Zyrën Vendore Arsimore Klos, janë pozicione pune që nuk janë pjesë e shërbimit civil dhe si rrjedhojë nuk janë subjekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, dhe Vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, për të cilët DAP-i është organ përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil.

Në analizë të veprimeve të kryera nga Departamenti i Administratës Publike rezulton se nga ana e këtij institucioni janë kryer të njëjtat veprime dhe është mbajtur i njëjti qëndrim lidhur me trajtimin e formularit të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të kandidatëve fitues të cilët rezultojnë të dënuar për veprën penale të shërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal).

⁵www.dap.gov.al/images/documents/Subjekte%20te%20Konstatuar%20ne%20Kushtet%20e%20Ndalimit%20te%20Ushtrimit%20te%20Funksionit.pdf

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e DAP-it, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për vlerësimin e formularit të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të kandidatëve fitues.
- Ankuesi nuk është vendosur në kushte të pabarabarta nga ana e DAP-it, pasi ky institucion ka mbajtur të njëjtin qëndrim për vlerësimin e formularit të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore dhe për kandidatët e tjerë fitues për pozicionet e punës ku kanë konkuruar.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se Departamenti i Administratës Publike, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkakun e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Departamenti i Administratës Publike ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 3/1, 5/1, neni 7/1, neni 12/1/b, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të D.P, për shkak të gjendjes shoqërore, në të drejtën për punësim, nga ana e Departamentit të Administratës Publike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA